



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KRYETARI

Nr. _____ Regj.

Ballsh, më ____ . ____ . 2021

Lënda: **Formulari i Njoftimit të Fituesit**

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK - TIRANË
(për publikim në SPE dhe buletin e njoftimeve publike)

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
BASHKIA MALLAKASTËR

Data 15.12.2021

Drejtuar: **“FEK 06” shpk**, me NIPT K67917806I, me adresë ushtrimi të aktivitetit sipas QKB:
Lagjja “5 Shkurti”, Ballsh

* * *

Procedura e prokurimit: **“Procedurë e hapur e thjeshtuar”**

Numri i referencës së procedurës: **REF-11852-11-17-2021**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Mirëmbajtje e mjeteve të transportit viti 2021”**, me fond limit **6,990,880** (gjashtëmilion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) **lekë pa TVSH**, me afat 12 (dymbëdhjetë) muaj.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike nr.167, datë 22 nëntor 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. **“FEK 06” shpk**, me NIPT K67917806I, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **6,857,700** (gjashtëmilion e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind) **lekë pa TVSH**.
2. **“SPARKLE 32” shpk**, me NIPT L51327014R, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **6,764,700** (gjashtëmilion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katërmijë e shtatëqind) **lekë pa TVSH**.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “SPARKLE 32” shpk, me NIPT L51327014R, për arsyet e mëposhtme:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën “2.3.1.”, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 8, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi kontratat e paraqitura nuk konsiderohen të ngjashme në kuptimin dhe thelbin e kontratave të shërbimit ku përveç furnizimit duhet edhe shërbimi i vendosjes ose montimit të pjesëve të këmbimit. Kontratat e paraqitura janë kontrata për furnizim mallrash dhe jo kontrata shërbimi dhe rrjedhimisht nga “SPARKLE 32” shpk, nuk plotësohet kjo kërkesë.
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën “2.3.2.”, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 8, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi referuar adresave të pasqyruara në ekstraktin e QKB-së, rezulton se “SPARKLE 32” shpk nuk disponon ambient/pikë servisi në një distancë jo më të largët se 10 kilometër nga qyteti i Ballshit, dhe rrjedhimisht nga “SPARKLE 32” shpk, nuk plotësohet kjo kërkesë.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik: **“FEK 06” shpk**, me NIPT K67917806I, me adresë ushtrimi të aktivitetit sipas QKB: Lagjja “5 Shkurti”, Ballsh, se oferta e paraqitur, me vlerë totale prej **6,857,700** (gjashtëmilion e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109, të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Qerim Ismailaj